



Türkiye İş Bankası A.Ş. – DEGA NË KOSOVË

PASQYRAT FINANCIARE TË PËRGATITURA NË
PËRPUTHJE ME RREGULLAT DHE RREGULLORET
E BANKËS QËNDRORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
MË DHE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2019
ME RAPORTIN E AUDITORIT TË PAVARUR



MAZARS

PËRMBAJTJA

Faqe

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

1

PASQYRAT FINANCIARE:

PASQYRA E POZITËS FINANCIARE

3

**PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA
GJITHPËPËRFSHIRËSE**

4

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET

5

PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË

6

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

7-47

RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR

Për drejtimin dhe aksionerët e Türkiye İş Bankası A.Ş. – DEGA NË KOSOVË

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të **Türkiye İş Bankası A.Ş. – DEGA NË KOSOVË** ("Banka") të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2019, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e flukseve të rrjedhës së parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës më datën 31 dhjetor 2019, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Rregullat dhe Rregulloret e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës ("BQK").

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen në mënyrë më të detajuar në paragrafin Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Banka në pajtim me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabel ("Kodi BSNEK") së bashku me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe të Kodit BSNEK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Theksim Çështje - Baza kontabël dhe kufizimi i përdorimit

Ne tërheqim vëmendjen për Shënimin 2 të pasqyrave financiare, i cili përshkruan bazën kontabël. Pasqyrat financiare janë përgatitur për të ndihmuar Bankën që të jetë në përputhje me kërkesat e raportimit financiar të "Rregullave dhe Rregulloreve" të përmendura më sipër. Si rezultat i kësaj, pasqyrat financiare mund të mos jenë të përshtatshme për ndonjë qëllim tjetër.

Raporti ynë i auditimit ka për qëllim vetëm informimin dhe përdorimin nga ana e Bankes dhe Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe nuk duhet të përdoret nga palë të tjera përveç Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Opinioni ynë nuk është i modifikuar për sa i përket kësaj çështjeje.

Çështje të tjera

Banka përgatit një set të veçantë të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, të cilat janë pasqyrat financiare të përgjithshme, të cilat do të publikohen pas datës së këtij raporti.

Pasqyrat financiare të **Türkiye İş Bankası A.Ş. - DEGA NË KOSOVË** për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 janë audituar nga një auditor tjetër i cili ka shprehur një opinion jo të modifikuar në lidhje me pasqyrat financiare më 5 mars 2019.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me rregullat dhe rregulloret e BQK-së, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomalitë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Bankës për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Bankës, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Bankës për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Bankës, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

 **MAZARS**
Mazars Kosova Sh.p.k
NUI: 811335597
RR. Ukshin Hoti Nr. 45/6, Prishtine
info@mazars.al www.mazars.al
Tëit Gjini
Auditues Ligjor

9 mars 2020

Türkiye İş Bankası A.Ş.-DEGA NË KOSOVË
PASQYRAT FINANCIARE

Pasqyra e pozitës financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019
(Shumat në Euro)

	Shënime	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Pasuritë			
Paraja në dorë dhe në bankë			
dhe balanca me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës	7	22,883,074	23,200,928
Plasmanet me banka	8	4,001,389	6,000,000
Investimet në letra me vlerë	9	5,177,446	2,118,926
Kreditë dhe avanset e dhëna klientëve	10	67,839,663	83,809,282
Pronat dhe pajisje	11	768,136	923,537
Pasuritë e paprekshme	12	88,464	95,311
E drejta e përdorimit të pasurisë së marrë me qira	13	2,014,959	-
Parapagimet e tatimit në të ardhura		9,486	12,840
Kolateralat e riposeduara	14	165,333	165,333
Pasuritë tjera	15	38,559	242,125
Totali i pasurive		102,986,509	116,568,282
Detyrimet			
Depozitat nga klientët	16	75,659,528	58,022,291
Huazime nga bankat	17	11,612,859	13,006,432
Huazime nga kompania mëmë dhe filialet	18	2,970,181	34,435,130
Detyrime tatimore të tjera	19	33,907	68,281
Të hyrat e shtyra	20	1,840	10,137
Detyrime tjera	21	137,043	92,717
Provizionet	22	97,795	-
Detyrimet e qirasë	23	1,984,407	-
Totali i detyrimeve		92,497,560	105,634,988
Kapitali aksionar			
Kapitali aksionar	24	10,000,000	10,000,000
Fitimi i akumuluar		488,949	933,294
Totali i kapitalit aksionar		10,488,949	10,933,294
Totali i detyrimeve dhe kapitalit aksionar		102,986,509	116,568,282

Këto pasqyra financiare janë përgatitur nga Deloitte Kosova sh.p.k dhe janë aprovuar më 5 mars 2020 nga:


Oguzhan Ceylan
Drejtor i degës në Kosovë
Türkiye İş Bankası A.Ş. – Dega në Kosovë


Afrorë Rudi
Partner, Kontabilist i çertifikuar
Deloitte Kosova sh.p.k

Shënimet shoqëruese në faqet 7 - 47 në vijim janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Türkiye İş Bankası A.Ş.-DEGA NË KOSOVË
PASQYRAT FINANCIARE

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019 (Shumat në Euro)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të hyrat nga interesi		4,696,567	5,084,412
Shpenzimet e interesit		(2,156,339)	(2,077,528)
Të hyrat neto nga interesi	25	2,540,228	3,006,884
Të hyrat nga tarifat dhe komisionet		268,435	321,155
Shpenzimet e tarifave dhe të komisioneve		(9,101)	(9,118)
Të hyra neto nga tarifat dhe komisionet	26	259,334	312,037
Fitimi neto nga këmbimi valutor	27	24,511	(45,494)
Të hyrat tjera	28	34,245	26,150
Totali i të hyrave operative		58,756	(19,344)
Shpenzimet			
Provizionet e kredive të dyshimta	10	87,179	909,720
Provizionet për garancione ndaj klientëve	21	(11,816)	5,054
Provizionet për pasuritë e mbajtura për shitje	14	-	(41,333)
Shpenzimet tjera operative	29	(968,207)	(992,662)
Përfitimet e punonjësve	30	(878,153)	(788,650)
Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit	11,12,13	(456,172)	(307,286)
Totali i shpenzimeve		(2,227,169)	(1,215,157)
Fitimi para tatimit		631,149	2,084,420
Tatimi mbi fitim	31	(142,200)	(224,252)
Fitimi neto për vitin		488,949	1,860,168
Të ardhura tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i fitimit gjithëpërfshirës për vitin		488,949	1,860,168

Shënimet shoqëruese në faqet 7 – 47 në vijim janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Türkiye İş Bankası A.Ş.-DEGA NË KOSOVË
PASQYRAT FINANCIARE

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019 (Shumat në Euro)

	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura/ Humbjet e akumuluar	Totali i kapitalit aksionar
Gjendja më 1 janar 2018	10,000,000	(926,874)	9,073,126
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin			
Fitimi për vitin	-	1,860,168	1,860,168
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën		1,860,168	1,860,168
<i>Kontributet nga dhe shpërndarjet për pronarët</i>	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	10,000,000	933,294	10,933,294
Gjendja më 1 janar 2019	10,000,000	933,294	10,933,294
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin			
Fitimi për vitin	-	488,949	488,949
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën	-	488,949	488,949
<i>Kontributet nga dhe shpërndarjet për pronarët</i>	-	(933,294)	(933,294)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	10,000,000	488,949	10,488,949

Shënimet shoqëruese në faqet 7 – 47 në vijim janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Türkiye İş Bankası A.Ş.-DEGA NË KOSOVË
PASQYRAT FINANCIARE

Pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019
(Shumat në Euro)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
I. Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi para tatimit		631,149	2,084,420
Rregullimet për zërat jo-në para:			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	11,12,13	456,172	307,286
Provizionet e kredive të dyshimta	10,21	(75,362)	(914,775)
Provizionet për çëshjtet ligjore	29	97,795	-
Të hyrat nga interesi	25	(4,696,567)	(5,084,412)
Shpenzimet e interesit	25	2,156,339	2,077,528
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative			
Lëvizjet në rezervat e detyrueshme me BQK-në	7	1,080,138	1,487,818
Rritja / (zvogëlimi) në plasmanet me banka	8	2,000,000	(6,000,000)
Huat dhe paradhëniet për klientët	10	15,820,315	(3,419,102)
Depozitat nga klientët	16	17,296,240	15,019,417
Detyrimet tatimore dhe detyrimet tjera	19,21	(1,864)	11,016
Të hyrat e shtyra	20	(8,297)	(13,679)
Pasuritë tjera	13	(32,845)	(236,356)
Kolaterale të riposeduara	14	-	(165,333)
Tatimi i paguar në të ardhura të korporatave	15	(131,562)	(121,500)
Interesi i paguar për të drejtën e përdorimit të pasurisë së marrë me qira	13	(144,497)	-
Interesi i paguar		(2,012,550)	(1,706,192)
Interesi i arkëtuar		4,905,228	4,885,171
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet operative (I)		37,339,831	8,211,308
II. Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Investimet në letra me vlerë	9	(3,032,087)	(1,497,628)
Blerjet e pronës dhe pajisjeve	11	(31,070)	(583,363)
Blerjet e pasurive të paprekshme	12	(4,722)	-
Paraja neto e përdorur për aktivitetet investuese (II)		(3,067,880)	(2,080,991)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Huamarrjet nga kompania mëmë	18	(31,116,818)	(7,948,392)
Ripagimet/Të hyrat nga huamarrjet	17	(1,400,000)	7,500,000
Dividendë të paguar		(933,294)	-
Detyrimet e qirasë	23	(59,555)	-
Paraja neto nga aktivitetet financuese (III)		(33,509,667)	(448,392)
IV. Rritja neto në para dhe ekuivalentët e		762,284	5,681,926
V. Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit	7	12,514,746	6,832,820
VI. Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit (IV + V)	7	13,277,031	12,514,746

Shënimet shoqëruese në faqet 7 - 47 në vijim janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Türkiye İş Bankası A.Ş.-DEGA NË KOSOVË
PASQYRAT FINANCIARE

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019
(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)

1. ENTITETI RAPORTUES

Türkiye İş Bankası A.Ş. – Dega në Kosovë ("Banka" ose "Dega") është një degë e Türkiye İş Bankası A.Ş., një entitet turk.

Banka operon si bankë komerciale dhe e kursimeve për të gjitha kategoritë e klientëve brenda Kosovës. Banka operon nën licencën bankare Nr. 011 të lëshuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. Dega është regjistruar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë me 19 nëntor 2012 dhe ka numër biznesi 70899345 si dhe numër fiskal 600886131. Gjatë vitit 2019, banka ka operuar me dy zyra. Një zyrë gjendet tek rr.Ukshin Hoti, 100 në Prishtinë ndërsa tjetra në Prizren, rruga Zahir Pajaziti.

2. BAZAT E PËRGATITJES

(a) Deklarata e pajtueshmërisë

Banka mban shënimet kontabël dhe përgatit pasqyrat financiare të parashikuara me ligj në përputhje me parimet e kostos historike si dhe sipas rregulloreve dhe rregullave të Bankës Qendrore të Kosovës ("Rregulloret e BQK") të cilat janë të aplikueshme për bankën. Rregulloret e BQK-së janë të bazuara në vendimin ligjor relevant që definon aplikimin e detyrueshem të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") në Kosovë, si dhe kërkesa tjera specifike, në veçanti sa i përket vlerësimeve të provizioneve mbi humbjet nga kreditë dhe pasuritë financiare. Këto kërkesa specifike nuk janë në përputhje me ato të SNRF në këtë aspekt, dhe pasqyrat financiare nuk duhet të lexohen si të përgatitura në pajtueshmëri me SNRF. Gjithashtu, direktivat e BQK-së nuk kanë adoptuar parimet e standardeve të reja dhe atyre të ndryshuara të SNRF të cilat janë efektive për periudhat raportuese që fillojnë me 1 janar 2018, më i rëndësishmi SNRF 9: Instrumentet Financiare, rrjedhimisht formati i prezentimit dhe klasifikimit të këtyre pasqyrave financiare është i bazuar në SNRF-të efektive nga 31 dhjetori 2017.

(b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike. Aktualisht, Banka nuk ka investime financiare të klasifikuara si "Të gatshme për shitje" apo zëra të tjera të matura sipas vlerës së drejtë.

(c) Parimi i vijueshmërisë

Menaxhmenti i bankës ka bërë një parashikim mbi aftësinë e bankës për të vazhduar me parimin e vijimësisë dhe mendon që ka burimet për të vazhduar biznesin për të ardhmen e parashikueshme. Gjithashtu, menaxhmenti nuk është i informuar për ndonjë paqartësi materiale që mund të hedhë dyshime serioze mbi aftësinë e bankës për të vazhduar me parimin e vijimësisë. Si rrjedhojë, pasqyrat financiare vazhdojnë të përgatiten në bazë të parimit të vijimësisë.

(d) Valuta funksionale dhe e prezantimit

Pasqyrat financiare janë prezentuar në Euro, që është edhe valuta funksionale e bankës.

(e) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me udhëzimet e BQK-së dhe parimet e SNRF kërkon që menaxhmenti të bëjë vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shifrat e raportuara të pasurive dhe detyrimeve, shpalosjet e pasurive dhe detyrimeve në grup në datën e pasqyrave financiare dhe shifrat e të ardhurave dhe shpenzimeve të raportuara gjatë periudhës raportuese. Megjithatë këto vlerësime bazohen në njohuritë më të mira të ngjarjeve dhe veprimeve aktuale, rezultatet mund të jenë të ndryshme nga ato vlerësime.

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL

Politikat kontabël të paraqitura në vijim janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e prezentuara në këto pasqyra financiare.

(a) Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet në valutë të huaj përkthehen në valutën funksionale sipas normave të këmbimit të datës së transaksionit. Pasuritë dhe detyrimet monetare të denominuara në valuta të huaja në datën e raportimit ripërkthehen në valutën funksionale sipas normës së këmbimit në atë datë. Pasuritë dhe detyrimet jomonetare të denominuara në valuta të huaja të cilat maten sipas vlerës së drejtë, përkthehen në valutën funksionale sipas normës së këmbimit në datën në të cilën është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat nga valuta e huaj që dalin nga ripërkthimi njihen si fitim ose humbje.

(b) Të hyrat dhe shpenzimet e interesit

Të hyrat dhe shpenzimet nga interesi njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën efektive të interesit. Norma efektive e interesit është norma e cila saktësisht diskonton pagesat dhe pranimet e vlerësuara të parave në të ardhmen përgjatë jetëgjatësisë së pritshe të pasurisë ose detyrimit financiar (ose nëse është e përshtatshme, një periudhe më të shkurtë) deri te vlera bartëse e pasurisë ose detyrimit financiar. Në kalkulimin e normës efektive të interesit, Banka vlerëson rrjedhën e ardhshme të parasë duke konsideruar të gjitha kushtet kontraktuale të instrumenteve financiare, por jo edhe humbjet e ardhshme kreditore.

Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin të gjitha kostot e transaksionit, tarifat e pranuar ose paguara të cilat janë pjesë integrale e normës efektive të interesit. Kostot e transaksionit janë kosto rritëse që i atribuohen direkt blerjes, lëshimit ose heqjes nga përdorimi të një pasurie ose detyrimi financiar.

Të hyrat dhe shpenzimet e interesit të paraqitura në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse përfshijnë interesin në pasuritë dhe detyrimet financiare të matura sipas koston së amortizuar dhe të kalkuluara sipas normës efektive të interesit.

Ashtu sic kërkohet nga rregullorja e Bankës Qendrore të Kosovës, banka nuk njeht të hyra nga interesi në pasqyrat e saj, për klientët jo - performues.

(c) Tarifat dhe komisionet

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet që janë pjesë integrale e normës efektive të interesit të një pasurie financiare ose detyrimi financiar, përfshihen në kalkulimin e normës efektive të interesit.

Të ardhurat tjera nga tarifat dhe komisionet - përfshijnë tarifat e shërbimeve të llogarive, komisionet e shitjeve, tarifat e plasmaneve-njihen kur kryhen shërbimet e ndërlidhura me to. Nëse zotimi për kredi nuk pritet të rezultojë në dhënie dhe tërheqjen e kredisë, atëherë tarifat e ndërlidhura me zotimin e kredisë njihen në bazë lineare përgjatë periudhës së zotimit.

Shpenzime tjera të tarifave dhe komisioneve ndërlidhen kryesisht me tarifa transaksionesh ose shërbimesh të cilat janë shpenzime në momentin që shërbimet pranohen.

(d) Shpenzimet e tatimit në të ardhura

Shpenzimet e tatimit në të ardhura përbëhen nga tatimet afatshkurtra dhe tatimi i shtyrë. Shpenzimet e tatimit në të ardhura njihen në fitim ose humbje deri në masën që një zë njihet direkt në kapital ose në të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi aktual

Tatimi aktual përbëhet nga tatimi që pritet të jetë i pagueshëm apo i arkëtueshëm në të ardhurat ose humbjet e tatueshme të vitit dhe çfarëdo rregullimi të tatimit të pagueshëm apo të arkëtueshëm nga vitet e kaluara. Llogaritjet në bazë të normave tatimore në fuqi ose që kanë hyrë në datën e raportimit.

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(d) Shpenzimet e tatimit në të ardhura (vazhdim)

Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet duke llogaritur diferencat e përkohshme në mes të vlerave bartëse të pasurive dhe detyrimeve për qëllim të raportimit financiar dhe shumave të përdorura për qëllime të tatimit. Tatimi i shtyrë duhet të matet sipas normave të tatimit që pritet të zbatohen në diferencat e përkohshme kur të kthehen, bazuar në ligjet në fuqi ose që kanë hyrë në fuqi në datën e raportimit. Tatimi i shtyrë njihet si pasuri e vetme deri në atë masë që në të ardhmen do të ketë fitime të mundshme të tatueshme në dispozicion kundrejt të cilës mund të shfrytëzohen diferencat e përkohshme.

Detyrimet tatimore të shtyra njihen për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme. Tatimit i shtyrë si pasuri edhe tatimi i shtyrë si detyrim rishikohen në secilën datë raportuese dhe zvogëlohen deri në atë masë që nuk është e mundshme që një përfitim tatimor, respektivisht një obligim tatimor, do të realizohet. Tatimi shtesë në të ardhura nga shpërndarja e dividendave njihet në të njëjtën kohë kur njihen edhe detyrimet për të paguar dividendin.

Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019 dhe 2018, nuk paraqiten diferenca që do të kërkonin njohjen e tatimit të shtyrë si pasuri apo tatimit të shtyrë si detyrim në pasqyrat financiare.

(e) Qiratë

Politikat e zbatueshme nga 1 janari 2019

Banka vlerëson në rastet kur kontratat në përbërjen e tyre kanë apo janë kontrata të qirasë. Banka e njeh të drejtën e shfrytëzimit të pasurisë si dhe detyrimeve që rrjedhin nga ajo qira, përveq kontratave afatshkurta të qirasë (të përcaktuara si qira për një periudhë 12 mujore apo më pak) dhe qiratë me kosto të ulët (sic janë kompjuterët personal, artikuj të vegjël për zyre, makinat apo telefonat). Për këto qira, Banka njeh pagesën e qirasë si shpenzim operativ mbi bazën e linjës së drejtë gjatë kohëzgjatjes së kontratës, përveç në rast kur ekziston ndonjë bazë tjetër më përfaqësuese e asaj kohe në të cilën përfitohen benefitet ekonomike nga pasuritë e marra me qira. Detyrimi i qirasë matet fillimisht me vlerën aktuale të pagesave të qirasë, të cilat nuk janë paguar në datën e njohjes fillestare, diskontuar duke përdorur normën diskontuse të qirasë. Në rast se kjo normë nuk mund të përcaktohet me lehtësi, atëherë Banka përdor normën e huamarrjeve. Pagesat e qirasë që përfshihen në matjen e detyrimit të qirasë, përfshijnë:

- Pagesat fikse të qirasë (përfshirë pagesat fikse në substancë), e zbritur për çdo pagesë për stimulimin e marrjes/dhënies së qirasë.
- Pagesat variable të qirasë që varen nga një indeks ose normë, e matur fillimisht duke përdorur indeksin ose kursin në datën e fillimit;
- Shuma që pritet të paguhet nga qiramarrësi nën garancitë e vlerës së mbetur;
- Çmimi i opsionit të blerjes, nëse qiramarrësi është i sigurt për të ushtruar opsionet për ndërprerjen e qirasë.
- Pagesat e ndëshkimeve për ndërprejen e kontratës, nëse termet e qirasë reflektojnë ushtrimin e një opsioni për të ndërprerë kontratën.

Detyrimi i qirasë paraqitet si një zë i veçantë në pasqyrën e pozicionit financiar. Detyrimi i qirasë matet më pas duke rritur vlerën kontabël për të reflektuar interesin mbi detyrimin e qirasë (duke përdorur metodën efektive të interesit) dhe duke reduktuar vlerën kontabël për të reflektuar pagesat e bëra për qiranë. Banka e ri-matet detyrimin e qirasë (dhe bën rregullimet përkatëse në lidhje me të drejtën e përdorimit të pasurisë) sa herë që:

- Afati i qirasë ka ndryshuar ose ka një ngjarje të rëndësishme apo ndryshim në rrethana që rezultojnë në një ndryshim në vlerësimin e ushtrimit të opsionit të blerjes, në këtë rast detyrimi i qirasë ri-matet duke zbritur pagesat e rishikuara të qirasë duke përdorur një normë të rishikuar diskontimi.

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(e) Qiratë (vazhdim)

- Pagesat e qirasë ndryshojnë për shkak të ndryshimeve në një indeks ose normë ose një ndryshim në pagesën e pritshme nën një vlerë të mbetur të garantuar, në të cilat raste detyrimi i qirasë rimatet duke zbritur pagesat e rishikuara të qirasë duke përdorur një normë të pandryshuar diskontimi (përveç nëse pagesat e qirasë ndryshojnë për shkak të një ndryshimi në një normë interesi të ndryshueshme, në këtë rast përdoret një normë e rishikuar e diskontimit).
- Një kontratë qiraje është modifikuar dhe modifikimi i qirasë nuk llogaritet si një qira e veçantë, në këtë rast detyrimi i qirasë rimatet bazuar në afatin e qirasë së qirasë së modifikuar duke zbritur pagesat e rishikuara të qirasë duke përdorur një normë të rishikuar diskontimi në datën e modifikimit.
E drejta e përdorimit të pasurisë përfshinë matjen fillestare të detyrimit përkatës të qirasë, pagesat e qirasë të bëra në ose para ditës së fillimit, të zbritura për çdo shumë të japur si stimul për të marrë/dhënë qiranë dhe çdo kosto fillestare direkte. Ato më pas maten me kosto, të zbritur për zhvlerësim të akumuluar dhe humbje nga zhvlerësimi.

Kurdoherë që Banka ka një detyrim për shpenzimet për çmontimin dhe heqjen e një pasurie të marrë me qira, zhvendosje të lokacionit ose të rivendos pasurinë në gjendjen e kërkuar nga termat dhe kushtet e qirasë, një provizion njihet dhe matet sipas SNK 37. Në atë masë që kostot lidhen me një të drejtë të shfrytëzimit të pasurisë, kostot përfshihen në pasurinë e tillë, përveç nëse ato shpenzime janë bërë për të prodhuar inventarë.

E drejta e përdorimit të pasurisë zhvlerësohet gjatë periudhës më të shkurtër të afatit të qirasë dhe jetës së dobishme të pasurisë. Nëse qiradhënësi transferon pronësinë mbi pasurinë ose koston e të drejtës së përdorimit të pasurisë, dhe kjo reflekton që Banka pret të ushtrojë një mundësi blerjeje, atëherë pasuria e tillë zhvlerësohet gjatë jetës së dobishme të kësaj pasurie. Zhvlerësimi fillon në datën e fillimit të qirasë. E drejta e përdorimit të pasurisë paraqitet si një linjë e veçantë në pasqyrën e pozicionit financiar.

Banka aplikon SNK 36 për të përcaktuar nëse e drejta e përdorimit të pasurisë ka rënë në vlerë dhe njëh në pasqyrat financiare ndonjë rënie në vlerë, siç përshkruhet në politikën e "Prona, impiantet dhe pajisjet". Qiraja e ndryshueshme që nuk varet nga një indeks ose normë nuk përfshihet në matjen e detyrimit të qirasë dhe të drejtën e përdorimit të pasurisë. Pagesat e ndërlidhura njihen si shpenzime në periudhën në të cilën ndodh ngjarja që shkaktonë ato pagesa dhe përfshihen në linjën "Shpenzime të tjera" në fitim ose humbje.

Si një gjë praktike, SNRF 16 lejon një qiramarrës të mos veçojë përbërësit jo-qira të kontratës, dhe në vend të kësaj të llogarisë për çdo qira dhe komponentë që nuk lidhen me qira, si një marrëveshje e vetme. Banka nuk e ka përdorur këtë praktikë. Për kontratat që përmbajnë një përbërës të qirasë dhe një ose më shumë komponentë të qirasë ose jo të qirasë, Banka shpërndan vlerësimin në kontratë për secilën komponentë të qirasë në bazë të çmimit relativ të pavarur të komponentit të qirasë dhe çmimit total të përbërësve jo-qira.

Banka ka zgjedhur të përdorë qasjen retrospektive të modifikuar në aplikimin e SNRF 16. Sipas qasjes së modifikuar retrospektive, qiramarrësi nuk do të duhet të rideklarojë informacionin krahasues financiar. Prandaj, data e aplikimit fillestar është dita e parë e periudhës vjetore të raportimit në të cilën një qiramarrës së pari zbaton kërkesat e standardit të ri të qirasë. Në datën e aplikimit fillestar të standardit të ri të qirasë, qiramarrësit do të njohin efektin kumulativ të aplikimit fillestar si një rregullim në bilancin fillestar të fitimeve të mbajtura që nga 1 janari 2019. Periudhat e mëparshme kanë mbetur ashtu siç është nën kërkesat e njohjes së SNK 17.

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

e) Qiratë (vazhdim)

Njohja fillestare përfshin llogaritjen e vlerës aktuale të të gjitha pagesave të qirasë së mbetur duke përdorur normën e huamarrjes të qiramarrësit në datën e aplikimit fillestar dhe deklarimin e detyrimit të qirasë në shumën e llogaritur në bilanc.

Për të llogaritur vlerat aktuale të pagesave të mbetura të qirasë, Banka përdori një normë interesi të caktuar nga Departamenti i Thesarit të Zyrës Qendrore. Norma e interesit të përdorur përfaqëson nivelin e huamarrjes që Grupi zakonisht ngarkon në huazimet ndërbankare. Banka ka përdorur një normë interesi prej 7.57% për pagesa të qirasë për degën e Prishtinës dhe Selisë qendrore, dhe ka përdorur një normë interesi prej 6.71% për të paguar pagesat e qirasë për degën e Prizrenit.

Ekzistojnë dy mundësi për matjen e të drejtës së përdorimit të pasurisë në periudhën kalimtare. Është e rëndësishme të theksohet se kjo bëhet në bazë të qirasë:

i) Qasja e parë është të matja e pasurisë sikur SNRF 16 të ishte aplikuar që nga data e fillimit të qirasë duke përdorur një normë skontimi bazuar në normën e huamarrjes shtesë të qiramarrësit në datën e aplikimit fillestar.

ii) Qasja e dytë është të matja e pasurisë në një shumë të barabartë me detyrimin e qirasë, të rregulluar nga shuma e çdo pagese të parapaguar ose akruale të njohur para datës së aplikimit fillestar.

Banka ka zgjedhur të zbatojë metodën e dytë më lartë dhe të matë detyrimin e qirasë të barabartë me të drejtën e përdorimit të pasurisë të rregulluar nga çdo parapagim. Zbatimi i SNRF 16 për qiramarrjet e klasifikuara më parë si qira operative nën SNK 17 rezultoi në njohjen e të drejtës së përdorimit të pasurisë në shumë prej 2,273,091 EUR (përfshirë qiratë e parapaguara) dhe detyrimet e qirasë prej 2,043,962 EUR.

Politika e zbatueshme deri më 1 janar 2019

Pagesat e bëra nën qiranë operative ngarkohen si shpenzime në linjë të drejtë përgjatë termave të qirasë.

(f) Instrumentet financiare

Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare njihen në pasqyrën e pozicionit financiar të Bankës kur Banka bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

Pasuritë dhe detyrimet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë. Kostot e transaksionit që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes ose emitimit të pasurive financiare dhe detyrimeve financiare (përveç pasurive financiare dhe detyrimeve financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes), i shtohen ose zbriten nga vlera e drejtë e pasurive financiare ose detyrimeve financiare, sipas rastit, në njohjen fillestare. Kostot e transaksionit që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes së pasurive financiare ose detyrimeve financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes njihen menjëherë në fitim ose humbje.

(g) Pasuritë financiare

Të gjitha blerjet ose shitjet në mënyrë të rregullt të pasurive financiare njihen dhe çregjistrohen në bazë të datës së tregtisë. Blerjet ose shitjet në mënyrë të rregullt janë blerje ose shitje të pasurive financiare që kërkojnë shpërndarjen e pasurive brenda afatit kohor të përcaktuar me rregullore ose konventë në treg.

Të gjitha pasurive e njohura financiare maten më pas në tërësi ose me koston e amortizuar ose me vlerën e drejtë, në varësi të klasifikimit të pasurive financiare.

Banka ka njohur në pasqyrat e saj financiare vetëm pasurive financiare që mbahen me kosto të amortizuar.

Türkiye İş Bankası A.Ş.-DEGA NË KOSOVË
PASQYRAT FINANCIARE

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019
(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(g) Pasuritë financiare(vazhdim)

Klasifikimi i pasurive financiare

Instrumentet e borxhit që plotësojnë kushtet e mëposhtme maten më pas me koston e amortizuar:

- a) Pasuria financiare mbahet brenda një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është të mbajë pasuritë financiare për të mbledhur flukset monetare kontraktuale; dhe
- b) Kushtet kontraktuale të pasurisë financiare lindin në data të specifikuara të fluksit të parave që janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi shumën kryesore të papaguar

Instrumentet e borxhit që plotësojnë kushtet e mëposhtme maten më pas me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDPATGJ):

- a) pasuria financiare mbahet brenda një modeli biznesi, objektivi i të cilit arrihet nga të dyja mbledhjet e flukseve monetare kontraktuale dhe shitja e pasurive financiare; dhe
- b) kushtet kontraktuale të pasurisë financiare lindin në data të përcaktuara flukset e parave që janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi shumën kryesore të papaguar.

Të gjitha pasuritë e tjera financiare maten më pas me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes (VDPFH). Përkundër kësaj më sipër, banka mund të bëjë zgjedhjet / përcaktimin e pakthyeshmë të mëposhtëm në njohjen fillestare të një pasurie financiare:

- a) Banka mund të zgjedhë në mënyrë të pakthyeshme për të paraqitur ndryshime të mëvonshme në vlerën e drejtë të një investimi në kapital në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, nëse përmbushen kritere të caktuara (shiko më poshtë); dhe
- b) Banka mund të përcaktojë në mënyrë të pakthyeshme një investim borxhi që plotëson koston e amortizuar ose kriteret e VDPATGJ të matura në VDPFH nëse duke bërë kështu eliminon ose zvogëlon ndjeshëm një mospërputhje të kontabilitetit (shiko më poshtë):

(i) Kostoja e amortizuar dhe metoda efektive e interesit

Metoda efektive e interesit është një metodë e llogaritjes së koston së amortizuar të një instrumenti borxhi dhe shpërndarjes së të ardhurave nga interesi për periudhën përkatëse.

Për pasuritë financiare, përveç pasurive financiare të cilat kanë rënë në vlerë, të blera ose të gjeneruara përbrenda portfolios së bankës (d.m.th. pasuritë të cilat janë të dëmtuara nga kredia në njohjen fillestare), norma efektive e interesit është norma që saktësisht zbrit vlerat e arkëtimeve të vlerësuara në të ardhmen (përfshirë të gjitha tarifat e paguara ose pranuar që formojnë një pjesë integrale të normës efektive të interesit, kostove të transaksionit dhe primeve ose zbritjeve të tjera) duke përjashtuar humbjet e pritura të kredisë, përgjatë jetës së pritshme të instrumentit të borxhit, ose, kur është e përshtatshme, një periudhë më të shkurtër, në vlerën kontabël bruto të instrumentit të borxhit në njohjen fillestare. Për pasuritë financiare që kanë rënë në vlerë, të blera ose të gjeneruara përbrenda portfolios së bankës, një normë efektive interesi e rregulluar nga kredia llogaritet duke zbritur flukset e vlerësuara të parasë së ardhshme, përfshirë humbjet e pritura të kredisë, në koston e amortizuar të instrumentit të borxhit në njohjen fillestare. Kostoja e amortizuar e një pasurie financiare është shuma në të cilën pasuria financiare matet në njohjen fillestare minus ripagimet e kryera, plus amortizimin kumulativ duke përdorur metodën e interesit efektiv të çdo ndryshimi midis asaj shume fillestare dhe shumës së maturimit, të rregulluar për çdo humbje kompensimi. Vlera kontabël neto e një pasurie financiare është kostoja e amortizuar e një pasurie financiare para se të rregullohet për çdo rënie në vlerë.

Të ardhurat nga interesi njihen duke përdorur metodën e interesit efektiv për instrumentet e borxhit të matur më pas me koston e amortizuar dhe në VDPATGJ. Për pasuritë financiare, përveç pasurive financiare të rëna në vlerë, të blera ose të gjeneruara brenda portfolios së bankës, të ardhurat nga interesi llogariten duke aplikuar normën efektive të interesit në vlerën kontabël bruto të një pasurie financiare, përveç pasurive financiare që më pas kanë rënë në vlerë (shiko më poshtë). Për pasuritë financiare që kanë rënë në vlerë, të ardhurat nga interesi njihen duke aplikuar normën efektive të interesit në koston e amortizuar të pasurisë financiare.

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(g) Pasuritë financiare (vazhdim)

(i) Kostoja e amortizuar dhe metoda efektive e interesit (vazhdim)

Nëse, në periudhat pasuese të raportimit, rreziku i kredisë në instrumentin financiar të dëmtuar, përmirësohet në mënyrë që pasuria financiare të mos bie në vlerë, të ardhurat nga interesi njihen duke aplikuar normën efektive të interesit në vlerën kontabël bruto të pasurisë financiare. Për pasuritë financiare të dëmtuara të blera ose të gjeneruara brenda portfolios së bankës, banka njeh të ardhura nga interesi duke aplikuar normën efektive të interesit të rregulluar nga kredia në koston e amortizuar të pasurisë financiare nga njohja fillestare. Llogaritja nuk kthehet në bazën bruto edhe nëse rreziku i kredisë i pasurisë financiare përmirësohet më pas në mënyrë që pasuria financiare të mos jetë më e zhvlerësuar. Të ardhurat nga interesi njihen në fitim ose humbje dhe përfshihen në zërin "të ardhura nga financimi - të ardhura nga interesi" (shënimi 25).

(ii) Instrumentet e borxhit të klasifikuar si në VDPATGJ

Obligacionet e korporatave të mbajtura nga Banka klasifikohen në VDPATGJ. Obligacionet e korporatave fillimisht maten me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit. Më pas, ndryshimet në vlerën kontabël të këtyre bonove të korporatave si rezultat i fitimeve dhe humbjeve të këmbimit valutor (shih më poshtë), fitimet nga zhvlerësimi ose humbjet (shiko më poshtë) dhe të ardhurat nga interesi të llogaritura duke përdorur metodën efektive të interesit (shiko (i) më lart) njihen në fitim ose humbje. Shumat që njihen në fitim ose humbje janë të njëjta me shumat që do të njiheshin në fitim ose humbje nëse këto obligacione të korporatave do të ishin matur me koston e amortizuar. Të gjitha ndryshimet e tjera në vlerën kontabël të këtyre bonove të korporatave njihen në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse dhe grumbullohen nën titullin e rezervës së rivlerësimit të investimeve. Kur këto obligacione të korporatave njihen si të njohura, fitimet ose humbjet kumulative të njohura më parë në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse klasifikohen në fitim ose humbje.

(iii) Pasuritë financiare në VDPFH

Pasuritë financiare që nuk plotësojnë kriteret për matjen me koston e amortizuar ose VDPATGJ (shiko më lartë) maten në VDPFH. Në mënyrë të veçantë:

- (a) Investimet në instrumentet e kapitalit neto klasifikohen si në VDPFH, përveç nëse Banka cakton një investim kapitali, i cili as nuk mbahet për tregti, as një konsideratë kontingjente që rrjedh nga një kombinim biznesi, si në VDPATGJ për njohjen fillestare.
- (b) Instrumentet e borxhit që nuk plotësojnë kriteret e koston së amortizuar ose kriteret e VDPATGJ klasifikohen si në VDPFH. Përveç kësaj, instrumentet e borxhit që plotësojnë ose kriteret e koston së amortizuar ose kriteret e VDPATGJ mund të përcaktohen si në VDPFH pas njohjes fillestare nëse një përcaktim i tillë eliminon ose zvogëlon ndjeshëm një matje ose mospërputhje të njohjes (të ashtuquajturat 'mospërputhje kontabël') që do të lindin nga matja aktivet ose detyrimet ose njohja e fitimeve dhe humbjeve prej tyre në baza të ndryshme. Banka nuk ka caktuar ndonjë instrument borxhi si në VDPFH.
- (c) Pasuritë financiare në VDPFH maten me vlerën e drejtë në fund të çdo periudhe raportimi, me çdo fitim ose humbje të vlerës së drejtë të njohur në fitim ose humbje në masën që ato nuk janë pjesë e një marrëdhënie mbrojtëse të caktuar. Fitimi ose humbja neto e njohur në fitim ose humbje përfshin çdo dividend ose interes të fituar në aktivin financiar dhe përfshihet në "zërin tjetër të fitimeve dhe humbjeve".

Türkiye İş Bankası A.Ş.-DEGA NË KOSOVË
PASQYRAT FINANCIARE

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019
(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(g) Pasuritë financiare (vazhdim)

(iv) Fitimet dhe humbjet e këmbimit valutor

- a) Sasia kontabël e pasurisë financiare që janë të shprehura në një valutë të huaj përcaktohet në atë valutë të huaj dhe të përkthyer në kursin e pikës në fund të çdo periudhe raportimi. Në mënyrë të veçantë, për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar që nuk janë pjesë e një marrëdhënieje të caktuar të mbrojtjes, diferencat e këmbimit njihen në fitim ose humbje në zërin tjetër të fitimeve dhe humbjeve;
- b) Për instrumentet e borxhit të matur në VDPATGJ që nuk janë pjesë e një marrëdhënieje të caktuar të mbrojtjes, diferencat e këmbimit në koston e amortizuar të instrumentit të borxhit njihen në fitim ose humbje në zërin tjetër të fitimeve dhe humbjeve. Diferencat e tjera të këmbimit njihen në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse në rezervën e rivlerësimit të investimeve;
- c) për pasuritë financiare të matura në VDPFH që nuk janë pjesë e një marrëdhënieje të caktuar të mbrojtjes, diferencat e këmbimit njihen në fitim ose humbje në zërin e "fitimeve dhe humbjeve të tjera"; dhe
- d) për instrumentet e kapitalit të matur në VDPATGJ, diferencat e këmbimit njihen në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse në rezervën e rivlerësimit të investimeve.

(v) Çregjistrimi i pasurive financiare

Banka çregjistron një pasuri financiare vetëm kur skadojnë të drejtat kontraktuale të fluksit të parave nga pasuria, ose kur transferon pasurinë financiare dhe në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së pasurisë në një entitet tjetër. Nëse Banka nuk transferon dhe nuk mban në masë të madhe të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe vazhdon të kontrollojë pasurinë e transferuar, Banka njeh interesin e saj të mbajtur një pasuri dhe një detyrim shoqërues për shumat që mund të duhet të paguajë.

Për çregjistrimin e një pasuri financiare të matur me koston e amortizuar, diferenca midis vlerës kontabël të pasurisë dhe shumës së vlerës së marrë dhe të arkëtueshme njihet në fitim ose humbje. Përveç kësaj, në çregjistrimin e një investimi në një instrument borxhi të klasifikuar si në VDPATGJ, fitimi ose humbja kumulative e grumbulluar më parë në rezervën e rivlerësimit të investimeve është riklasifikuar në fitim ose humbje.

(vi) Shlyerja e pasurive

Banka shlyen pasuritë financiare, tërësisht ose pjesërisht, kur ka shteruar të gjitha përpjekjet praktike të rimëkëmbjes dhe ka konkluduar se nuk ka ndonjë pritje të arsyeshme të rimëkëmbjes. Treguesit se nuk ka ndonjë pritje të arsyeshme të rimëkëmbjes përfshijnë (i) ndërprerjen e veprimtarisë përmbartimore dhe (ii) kur metoda e rimëkëmbjes së Bankës është mbyllje e detyrueshme mbi kolateralin dhe vlera e kolateralit është e tillë që nuk ka ndonjë pritje të arsyeshme të rikuperimit të plotë. Banka mund të fshijë pasuritë financiare që janë ende subjekt i veprimtarisë përmbartimore.

(f) Detyrimet financiare

